

2012

PLANI I BIZNESIT I INFRAKOS



Fushë Kosovë
Tetor 2011

PËRMBAJTJA		Faqe
I.	Historia e Infrakosit	2
II.	Vizioni dhe misioni	2
III.	Prezantimi i biznesit	2
IV.	Shërbimet të cilat ne i ofrojmë	4
V.	Analiza e tregut	6
VI.	SWOT Analiza	8
VII.	Analiza financiare	9
VIII.	Objektivat e biznesit	10
IX.	Strategjia dhe zbatimi	10
X.	Resurset e nevojshme dhe buxheti	11
XI.	Mekanizmat përcjellës të planit të biznesit	13
XII.	Detyrimet karshi konsumatorëve dhe publikut	14

I. Historia e Infrakosit

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA - INFRAKOS është krijuar në bazë të vendimit të qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 05/110 të datës 26.02.2010 mbi ndarjen e Hekurudhave të Kosovës ShA në dy kompani të reja:

1. Infrastrukturën e Hekurudhave të Kosovës ShA (INFRAKOS); dhe
2. Operimin me Trena të Hekurudhave të Kosovës ShA (TRAINKOS).

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA - INFRAKOS si kompani e cila veprimtari kryesore e ka biznesin e ofrimit të shërbimeve të infrastrukturës për ndërmarrjet transportuese hekurudhore, ka filluar të veprojë si kompani në vete që nga data 01.09.2011.

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA (INFRAKOS) si njëra ndër pasueset e Hekurudhave të Kosovës ShA, në tërësi është një kompani publike në pronësi të shtetit dhe si e tillë është pronar dhe menaxher i infrastrukturës hekurudhore të Kosovës.

II. Vizioni dhe misioni

II. 1 Vizioni

Të jemi prijës në ofrimin e linjave hekurudhore dhe shërbimeve tjera të infrastrukturës për të gjithë operatorët e transportit hekurudhor brenda dhe jashtë vendit në mënyrë të barabartë, transparente dhe jodiskriminuese. Që të jemi ofrues tërheqës dhe më i efektshëm i rrjetit hekurudhor në rajonin e Ballkanit perëndimor.

II. 2 Misioni

Për të ofruar një rrjet hekurudhor konkurrues, të qëndrueshëm dhe të suksesshëm në përputhje me nevojat e shoqërisë dhe ekonomisë së Kosovës dhe më gjerë, duke i plotësuar kërkesat e sigurisë, të ambientit dhe ato ekonomike.

III. Prezantimi i biznesit

Para 132 vitesh, gjegjësisht në vitin 1874 u ndërtua vija e parë hekurudhore në Kosovë në relacionin Hani i Elezit – Fushë Kosovë – Mitrovicë. Ishte ky fillimi i shtrirjes së rrjetit hekurudhor nëpër Kosovë, aq sa i rëndësishëm për transportin e udhëtarëve dhe mallrave, po aq i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe lidhjen e Kosovës me vendet e rajonit. Në vitin 1931 vazhdoi ndërtimi i kësaj linje në relacionin Mitrovicë – Leshak,


më 1934 ajo Fushë Kosovë – Prishtinë, më 1936 Fushë Kosovë – Pejë, më 1949 Prishtinë – Podujevë – Livadhi dhe më 1963 Klinë – Prizren.

Kështu që sot rrjeti hekurudhor i Hekurudhave të Kosovës përmes Leshakut dhe Podujevës në veri dhe lindje është i lidhur me Serbinë, ndërsa përmes Hanit të Elezit, në jug me Maqedoninë.

Infrakosi i menaxhon dhe mirëmban 333 km të linjave ekzistuese hekurudhore, 105 kilometra në stacione dhe mbi 100 kilometra linja industriale, sistemet e sinjalizimit, sistemet e komunikimeve, sistemet e energjetikës, 32 stacione hekurudhore, 115 ura me gjatësi prej 2988 metrash, 23 tunele me gjatësi prej 9020 metrash, 759 lëshesa dhe 257 vendkalime në nivel, si dhe ndërtesa tjera dhe pronën tokësore.

Përveç organizimit të trafikut hekurudhor, biznesi i infrastrukturës hekurudhore ka të bëjë edhe me ndërtimin e binarëve industrial dhe infrastrukturës tjetër hekurudhore për nevoja të kompanive të ndryshme, si dhe dhënien me qira të pronës hekurudhore për përfitime komerciale.

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA – INFRAKOS, që nga fillimi i punës më datën 01 shtator 2011 ka pasur 285 të punësuar të cilët janë në marrëdhënie të rregullt pune me Infrakosin. Numri i të punësuarve është trashëguar pas ndarjes së HK-së dhe



për momentin i plotëson kërkesat bazë për mirëmbajtjen dhe ofrimin e shërbimeve përkatëse në infrastrukturën ekzistuese hekurudhore.

Struktura e këtyre të punësuarve varësisht nga kategoritë e ndara më poshtë është si vijon:

- Në kohë të pacaktuar gjithsejtë janë 217 ose 76.14% punëtorë
- Në kohë të caktuar gjithsejtë janë 68 ose 23.85% punëtorë
- Moshë mesatare e të punësuarve në Infrakos është 48,27 vjeç
- Meshkuj gjithsejtë janë 276 ose 96,84% të punësuarve
- Femra gjithsejtë janë 9 ose 3,15% të punësuarve
- Shqiptar janë 276 ose 96.84% të punësuar
- Serb janë 7 ose 2.45 % të punësuar
- Romë dhe ashkali 2 të punësuar ose 0.7%
- Me shkollë fillore/ të kualifikuar nga HK janë 58 të punësuar ose 20.35%
- Me shkollë të mesme janë 190 ose 66.66% të punësuar

- Me shkollë të lartë janë 10 ose 3.50% të punësuar dhe
- Me shkollim superior janë 27 ose 9,47% të punësuar.

Nga të dhënat e verifikuara del se problem shqetësues për Infracosin edhe më tutje është: moshja e vjetër e punonjësve dhe struktura gjinore e tyre. Moshja e vjetër e punonjësve drejtpërdrejtë ndikon dhe sjell problemin e mosnjohjes apo njohjes së limituar të teknologjisë së re, përshtatjes me vështirësi të ndryshimeve teknologjike, përmbushjes së kërkesave të tregut, etj.

IV. Shërbimet të cilat ne i ofrojmë

Infracosi si i vetmi menaxher i infrastrukturës hekurudhore në Kosovë ofron këto shërbime:

1. Qasjen në infrastrukturën hekurudhore e cila përfshinë:
 - Ofrimin e linjave hekurudhore për operatorët hekurudhor në transportin e udhëtarëve; dhe
 - Ofrimi i linjave hekurudhore për operatorët hekurudhor në transportin e mallrave;
2. Menaxhimin e komunikacionit hekurudhor i cili përfshinë:
 - Rregullimin e qarkullimit të trenave të udhëtarëve nëpër tërë rrjetin hekurudhor;
 - Rregullimin e qarkullimit të trenave të mallrave nëpër tërë rrjetin hekurudhor;
 - Vendosjen e trenave në binarët industrial;
 - Formimin dhe shformimin e trenave; dhe
 - Ofrimin e shërbimeve tjera sekondare për operatorët e transportit.
3. Mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore e cila përfshinë:
 - Mirëmbajtjen e binarëve, urave, tuneleve, lëshesave dhe vendkalimeve në nivel; dhe
 - Mirëmbajtjen e stabilimenteve sinjalo-siguruese, telekomunikacionit dhe energjetikës;
4. Modernizimin dhe zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore i cili përfshinë:
 - Modernizimin e të gjitha linjave ekzistuese hekurudhore sipas strategjive zhvillimore dhe arsyeshmërisë ekonomike; dhe
 - Zhvillimin e linjave hekurudhore për plotësimin e kriterëve teknike të interoperabilitetit;
5. Mirëmbajtjen dhe ndërtimin e binarëve industrial dhe privat që përfshinë:

- Ndërtimin e binarëve industrial privat sipas kërkesave të klientëve; dhe
 - Mirëmbajtjen e binarëve industrial privat sipas kërkesave të klientëve.
6. Ofrimin e shërbimeve të ngarkim-shkarkimit në terminalin e mallrave i cili përfshinë:
- Ngarkimi dhe shkarkimi i kontejnerëve me kranin mobil;
 - Ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave tjera me piruner; dhe
 - Ofrimin e shërbimeve tjera sekondare në kuadër të terminalit.
7. Zhvillimin dhe shfrytëzimin më funksional të pronës hekurudhore i cili përfshinë:
- Dhënien me qira të banesave të cilat janë në pronësi të infrakosit;
 - Dhënien me qira të lokaleve për zhvillimin e bizneseve private;
 - Dhënien me qira të depove dhe objekteve tjera; dhe
 - Dhënien me qira të sipërfaqeve të zbrazëta tokësore për nevoja të ndryshme.



Qasia në infrastrukturën hekurudhore



Menaxhimi i trafikut hekurudhor




Mirëmbajtja e infrastrukturës



Ndërtimi i binarëve industrial privat



Shërbimet e terminalit



Zhvillimi i liniave të reia hekurudhore

V. Analizat e tregut

Qasja në rrjetin hekurudhor - Infrakosi si biznes kryesor të vetin e ka ofrimin e traseve të trenit për operatorët e transportit hekurudhor dhe duke qenë i vetmi ofrues i këtyre shërbimeve në Kosovë, duhet të jetë i përgatitur maksimalisht që shërbimet e qasjes në rrjetin hekurudhor të jenë të nivelit më të lartë në mënyrë që të jemi atraktiv për të gjithë operatorët e transportit.

Për momentin ekziston vetëm një operator i transportit (Trainkosi) dhe ne shërbimet e qasjes në rrjet mund të ia ofrojmë vetëm këtij operatori. Për këtë deri në futjen e operatorëve tjerë, dëshira e jonë është që Trainkosi të jetë shumë i suksesshëm në veprimtarinë e transportit të mallrave dhe udhëtarëve, sepse të hyrat tona kryesore do të jenë nga ky operator.

Terminali i mallrave – Një sektor i rëndësishëm i cili i sjellë të ardhura Infrakosit është terminali hekurudhor i cili ofron shërbimet e ngarkim shkarkimit të mallrave. Në analizat e mëposhtme ne kemi përdorur të dhënat nga vitit 2010 dhe për periudhën janar – shtator 2011. Kjo është bërë në mënyrë që analiza jonë të jetë e krahasueshme në baza vjetore për të gjitha shërbimet e mëposhtme.

Sipas të dhënave nga sektori i financave të Infrakosit, në periudhën janar – dhjetor 2010 dhe janar – shtator 2011 të dhënat mbi terminalin e mallrave janë prezantuar në tabelën vijuese:

Tabela 1. Shërbimet e terminalit

Viti	2010	Janar-shtator 2011
Të hyrat në Euro	95,224	51,175
Numri i kontejnerëve	740	725

Patundshmëria - Sipas të dhënave nga sektori i patundshmërisë, për dhënien me qira të tokave, banesave dhe lokaleve afariste më poshtë do të paraqesim të hyrat nga patundshmëria si dhe numrin e kontratave të cilat i kemi realizuar gjatë vitit 2010 dhe gjatë periudhës *janar – shtator* 2011.

Tabela 2. Shërbimet e patundshmërisë

Viti	2010	Janar-shtator 2011
Të hyrat në Euro	577,659	719,940
Numri i kontratave	293	278

Binarët industrial - Sipas të dhënave nga sektori i mirëmbajtjes së vijave hekurudhore të HK-së, për ndërtimin e binarëve industrial privat, më poshtë do të paraqesim të hyrat nga MLH-ja si dhe numrin e binarëve industrial dhe privat të cilat i kemi realizuar përgjatë vitit 2010. Vlen të ceket se në vitin 2011 nuk është ndërtuar asnjë binar industrial, por Infrakosi në të ardhmen përveç ndërtimit të binarëve do të bënë edhe mirëmbajtjen e tyre e cila mirëmbajtje do të krijoj të hyra të konsideruara.

Tabela 3. Shërbimet e binarëve industrial

Viti	2010	Janar-shtator 2011
Të hyrat në Euro	11,263	00
Numri i binarëve	2	00

VI. SWOT analiza

Fuqitë (Përparësitë)	Dobësitë (Mangësitë)
<ul style="list-style-type: none"> ✓ I vetmi operator i cili ofron qasje në binarë ✓ Kyçja në binarë industrial në pjesën më të madhe të minierave në Kosovë; ✓ Ofrimi i shërbimeve të terminalit për ngarkim shkarkimin e mallrave; ✓ Linja e 10 hekurudhore është linjë lidhëse ndërmjet Serbisë, Kosovës dhe Maqedonisë; ✓ Kapacitetet e infrastrukturës ekzistuese lejojnë edhe futjen e operatorëve tjerë të transportit; ✓ Eksperienca e gjatë në këtë biznes. 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Gjendja jo e mirë e infrastrukturës hekurudhore; ✓ Mosfunksionimi i një pjese të infrastrukturës hekurudhore; ✓ Kostoja e lartë e mirëmbajtjes së infrastrukturës hekurudhore; ✓ Mungesa e stabilimenteve sinjalo-siguruese në të gjitha linjat hekurudhore, përveç linjës së 10 ✓ Moshja e vjetër e punëtorëve, produktiviteti i ulët;
Mundësitë (Shanset)	Rreziqet (Kërcënimet)
<ul style="list-style-type: none"> ✓ Lidhja e të gjitha qyteteve kryesore të Kosovës mundëson zhvillimin e transportit hekurudhor; ✓ Lidhja me vendet e rajonit përmes linjës së 10 hekurudhore; ✓ Rehabilitimi dhe futja në funksion edhe e linjave tjera hekurudhore; ✓ Infrastruktura e mirë jep mundësi për shtimin e operatorëve të transportit. 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Mosfunksionimi i mirë i Trainkosit ✓ Financimit jo i mjaftueshëm i projekteve zhvillimore të infrastrukturës ✓ Obstruksionet e vazhdueshme nga Hekurudhat Serbe dhe bllokimi i daljes veriore për në Serbi; ✓ Kostoja e lartë e investimeve në mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e linjave jashtë funksionit; ✓ Pamundësia e përtëritjes së mekanizimit për mirëmbajtjen e linjave hekurudhore.

VII. Analiza financiare

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA – INFRAKOS, përkundër vështirësive të ndryshme parasheh të zhvilloj afarizmin e vetë me një trend të avancimit të lehtë në krahasim me vitet paraprake. Këtë duke e pas parasysh se përveç shpenzimeve operacionale të domosdoshme për funksionim nevojiten edhe burime financiare për projekte kapitale. Aktualisht burimi i vetëm për këto investime është BKK-ja (Buxheti i Konsoliduar i Kosovës) nga i cili burim në vazhdimësi është financuar HK-ja vetëm për të mirëmbajtur infrastrukturën ekzistuese.

Nga ajo që është thënë më lartë është potencuar se biznesi i Infrakosit mbështetet në dhënien në shfrytëzim të traseve të trenit si dhe nga dhënia me qira e patundshmërisë. Duhet të potencojmë se që në fillim të ndarjes kanë lindur mosmarrëveshje rreth pagesave të Trainkosit për shfrytëzim të rrjetit hekurudhor. Lidhur me këtë Infrakosi është duke punuar me të madhe në përfundimin e Ekspozeut të Rrjetit me të cilin dokument përcaktohen pagesat e qasjes në rrjetin hekurudhor për tren kilometër. Ne shpresojmë që qeveria do ta miraton këtë dokument, në mënyrë që për vitin 2012 të mos kemi problem inkasimin e mjeteve për shfrytëzim të rrjetit.

Infrakosi përveç të hyrave nga qasja në rrjet, llogaritë edhe të hyrat nga qiraja e dhënies në shfrytëzim të patundshmërisë si dhe qiraja nga kablloptike sipas kontratës me PTK-në. Sa i përket të hyrave nga patundshmëria, ne kemi marrë një aksion gjithëpërfshirës në përpilimin e politikave për menaxhimin më të mirë të patundshmërisë me çka do të rritej edhe inkasimi i mjeteve.

Ne po ashtu planifikojmë të hyra edhe nga mirëmbajtja dhe ndërtimi i binarëve privat industrial, mirëmbajtja e të cilëve deri më tani për shkak të interesit të transportit të mallrave është bërë me kosto shumë të ulët.

Një problem në vete paraqet edhe mosrealizimi i pagesave të KONET-it sipas kontratës së koncesionit. Ne pas shumë e shumë diskutimeve, premtimeve dhe vendimeve të ndryshme jemi detyruar që kësaj kompanie të ia ndërpresim operimin. Angazhimet tona janë të shumta në drejtim të gjetjes së një modeli të ndërprerjes së kontratës së koncesionit me këtë kompani në mënyrë që pastaj të mund t'i shesim shërbimet e kablloptike klientëve të ndryshëm dhe me këtë të përfitojmë të hyra tjera të cilat për momentin nuk i kemi planifikuar.

Më lartë u tha se ndërtimi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i infrastrukturës hekurudhore varet nga financimi i BKK-së. Infrakosi për vitin 2012 ka kërkesa shumë më të mëdha se sa që janë bërë planifikimet e para të BKK-së. duke parë se nevoja e jonë është e madhe dhe se premtimet e BKK-së arrin vlerën prej 15,601,000.00 eurosh, ne jemi të detyruar që të zhvillojmë vetëm projektet emergjente të cilat janë të lidhura me sigurinë e komunikacionit hekurudhor. Për këtë ne jemi fokusuar në riparimin e tuneleve dhe blerjen e makinës pllaser për rregullimin e binarëve të cilat janë projekte në vazhdimësi, si dhe në blerjen e pjesëve rezervë për infrastrukturë të cilat janë të domosdoshme për

mirëmbajtjen e nivelit të duhur të infrastrukturës hekurudhore për një zhvillim të sigurt të komunikacionit hekurudhor.

VIII. Objektivat e biznesit

Që të arrimë nivelin e dëshiruar të mirëmbajtjes së infrastrukturës hekurudhore, në vijim janë paraqitur objektivat tona për vitin 2012:

- Ofrimi me kohë dhe korrekt i të gjitha shërbimeve ndaj operatorëve të transportit për qasjen në rrjetin hekurudhor;
- Menaxhimi me sukses patundshmërisë drejt ngritjes së inkasimin të të hyrave
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e binarëve industrial;
- Ngritja e sigurisë në komunikacionin hekurudhor;
- Përmirësimi i proceseve të brendshme;
- Ngritja e efikasitetit në realizimin e projekteve;
- Përmirësimi i nivelit të shërbimeve;
- Përmirësimi i gjendjes së mjeteve të mekanizimit për mirëmbajtjen e binarëve;
- Mirëmbajtja e infrastrukturës për mbajtje në funksion të linjave hekurudhore;
- Përmirësimi i sistemit të komunikimit brenda dhe me klient ,
- Të rrisim efektivitetin në dhënie të shërbimeve,
- Ndryshimi i kulturës biznesore të punonjësve të kompanisë bazuar në të arriturat e reja teknologjike
- Ngritja profesionale dhe ripërtëritja e stafit;
- Përmirësimi i strukturës gjinore.
- Përmirësimi i kushteve të punës për stafin;

IX. Strategjitë e arritjes së objektivave dhe zbatimi i tyre

Në mënyrë që të arrijmë objektivat e lartcekura për vitin 2012 ne kemi kombinuar disa strategji në mënyrë që rezultati të jetë më i mirë dhe më lehtë i matshëm.

Në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore të qasjes në rrjetin hekurudhor, ne do të zbatojmë me përpikëri Ekspozeun e Rrjetit i cili është baza kryesore mbi të cilën kryhen pothuajse të gjitha operimet. Njëkohësisht do të zbatojmë me rigorozitet të gjitha rregulloret dhe legjislacionin tjetër ekzistues i cili ka të bëjë me sektorin hekurudhor.

Në shërbimin e patundshmërisë ne do ta përdorim strategjinë depërtuese e cila do të orientohet në zbrazësitë e identifikuar që kemi në treg. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe përpilimit të tarifave të reja.

Një politikë e saktë dhe e efektshme do të përpilohet edhe sa i përket mirëmbajtjes së binarëve industrial dhe ndërtimit të tyre eventual;

Ndërsa sa i përket realizimit të objektivave tjera që janë cekur më lartë qasja jonë do jetë e fokusuar në:

- ✚ Kontrollin e kualitetit të punëve karshi rregulloreve dhe standardeve adekuate;
- ✚ Aplikimin e teknologjisë informative dhe digjitalizimin e proceseve të punës;
- ✚ Aplikimin e sistemit të shpërblimit dhe ndëshkimit karshi performancës së treguar;
- ✚ Shkollimin dhe trajnimet e stafit karshi zhvillimit të fushave përkatëse; dhe
- ✚ Gjetja e mundësive për punësime të reja.

X. Resurset e nevojshme dhe buxheti

Në mënyrë që të jemi në gjendje të realizojmë objektivat e lartpërmendura gjatë vitit 2012 ne i kemi kategorizuar resurset e nevojshme që duhet siguruar me kohë.

Këto resurse ne i kemi ndarë në tri kategori dhe atë:

- ✚ Resurse tekniko teknologjike;
- ✚ Resurse njerëzore; dhe
- ✚ Resurse financiare që në të njëjtën kohë i mbulon edhe dy resurset e lartpërmendura.

X.1 Resurset tekniko teknologjike

Duke marrë për bazë objektivin tonë kryesor për vitin 2012 i cili ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve cilësore për qasjen në rrjetin hekurudhor, është e domosdoshme që infrastruktura hekurudhore (linjat hekurudhore, urat, tunelet, shtresa e ultë, shtresa e lartë, pajisjet sinjalo-siguruese, pajisjet e telekomunikacionit, pajisjet e energjetikës, ndërtesat e stacioneve dhe objektet tjera të infrastrukturës) të jenë në nivelin e duhur dhe t'i plotësojnë standardet e kërkuara në mënyrë që komunikacioni hekurudhor të kryhet pa problem.

Që të arrihet kjo që u tha më lartë nevojiten këto resurse tekniko teknologjike:

- Një makinë për rregullimin e binarëve dhe ndërrueseve;
- Për rregullimin e kanaleve përgjatë vijës hekurudhore duhet edhe një ekskavator;
- Për bartjen e materialit punues dhe personelit të vijave hekurudhore duhen së paku dy mjete të destinuara për këtë veprimtari (drezina);
- Makina tjera të vogla për mirëmbajtjen e binarëve; dhe
- Pjesë të ndryshme rezervë për funksionimin e sektorit të SS, TK dhe EN.

Makina për rregullimin e binarëve dhe pjesët rezervë të SS, TK dhe EN janë paraparë si projekte në vazhdimësi nga BKK-ja, ndërsa ekskavatori dhe drezinat pritet të financohen po ashtu nga BKK-ja pas revidimit të buxhetit në vitin 2012.

X. 2 Resurset njerëzore

Ndarja e Hekurudhave të Kosovës ka ndikuar që të ndihet një mungesë e konsideruar edhe në numrin e stafit administrativ. Kërkesat kanë qenë bukur të mëdha, mirëpo duke marrë parasysh situatën ekzistuese financiare dhe dëshirën që të mos krijohen shpenzime të mëdha shtesë, ne për vitin 2012 kemi bërë vetëm planifikimin e një numri të vogël të punonjësve të rinj, duke i shpërndarë kështu detyrat dhe përgjegjësitë në stafin ekzistues të të punësuarve.

Në mënyrë që të realizojmë objektivat e lartcekura ne kemi planifikuar që gjatë vitit 2012 t'i plotësojmë nevojat tona me resurse njerëzore të nevojshme dhe atë me 7 deri në 9 punonjës të rinj të cilët do të jenë të shpërndarë në fusha të ndryshme të kompanisë dhe të cilët do të jenë kryesisht të rinj në moshë dhe aty ku është e mundur me kualifikim superior.

Planifikimet tona janë për këto punësime:

1. Ekonomist të diplomuar	4 persona
2. Inxhinier të diplomuar	6 persona
3. Përcjellës të trenave	4 persona
4. Punonjës të tjerë sipas nevojave emergjente	2 persona

Ekonomistët nevojiten për Departamentin e Financave, ndërsa inxhinierët e diplomuar nevojiten në ekzekutivë dhe atë në komunikacion dhe ndërtimtari në mënyrë që të përmirësohet struktura e kadrovike dhe të mund të zëvendësohen kuadrot ekzistuese të cilat janë afër pensionimit.

Brenda këtij planifikimi ne mendojmë se në të gjitha vendet që konsiderohet e përshtatshme t'i japim përparësi gjinisë femërore në punësim.

Për realizimin e objektivave të parapara, në vitin 2012 është planifikuar të bëhet punësimi edhe i 9 punonjësve të profileve të ndryshme.

X. 3 Resurset financiare të nevojshme

Resurset e nevojshme financiare për realizimin e objektivave të planit të biznesit janë strukturuar në mënyrë që të paraqitet burimi i krijimit të këtyre resurseve si dhe shpërndarja e këtyre resurseve sipas linjave buxhetore në mënyrë që të kemi të qartë destinimin e këtyre resurseve sipas planit të biznesit në përgjithësi.

Tabela 4. Pasqyra e buxhetit operativ 2012 – Të hyrat

Nr	Përshkrimi	Buxheti i rishikuar 2011
1	Të hyrat nga shfrytëzimi i rjetit	2,568,000
2	Të hyrat nga qiraja	592,559
3	Të hyrat tjera	228,866
Gjithsejtë të hyrat		3,389,425

Tabela 5. Pasqyra e buxhetit operativ 2012 – Shpenzimet

Nr	Përshkrimi	Buxheti i rishikuar 2011 / Vlera
1	Pajisjet	50,200.00
2	Harxhimet në lokale (ndërtesa)	81,000.00
3	Energjia elektrike	150,000.00
4	Nafta	60,000.00
5	Vajrat, lubrifikantët etj.	25,100.00
6	Materiali harxhues operativ	94,200.00
7	Riparimet	260,300.00
8	Shërbimet operative	10,000.00
9	Udhëtimet zyrtare	68,570.00
10	Marketingu dhe publikimet	37,360.00
11	Materiali i zyrës dhe konsumues	42,200.00
12	Telefoni, posta dhe interneti	15,100.00
13	Shpenzimet e rrezikshmërisë	144,200.00
14	Reprezentacioni / konsumuese	22,800.00
15	Sigurimi	8,700.00
16	Stafi i jashtëm	25,000.00
17	Stafi dhe punëtorët	1,892,300.00
18	Shpenzimet tjera operative	211,800.00
Gjithsejtë shpenzimet operative		3,198,830

Tabela 6. Projektet kapitale për vitin 2012

Nr	Emri i Projektit	Burimi i financimit	Viti 2012
1	Renovimi i tuneleve në linjat hekurudhore	BKK	561,000
2	Furnizimi me pjesë rezervë të infrastrukturës	BKK	700,000
3	Blerja e makinës për rregullimin e binarëve	BKK	300,000
Totali			1,561,000

XI. Mekanizmat përcjellës të planit të biznesit

Në mënyrë që të kemi një përcjellje në kohë të duhur për veprim të rezultateve të këtij plani ne do të përdorim disa mekanizma matës për secilën objektiv kryesisht në këto pika :

- ✓ Monitorimi permanent i realizimit të të hyrave dhe realizimit të shpenzimeve;
- ✓ Monitorimi i rritjes/rënies së kërkesave në të gjitha fushat e veprimit të kompanisë;
- ✓ Monitorimi i përfitimit të klientëve të rinj;
- ✓ Monitorimi i mbajtjes së klientëve ekzistues dhe potencial;
- ✓ Monitorimi i kënaqshmërisë së klientëve tanë me shërbimet e ofruara,
- ✓ Monitorimi i shfrytëzimit sa ma racional të mjeteve të punës;
- ✓ Monitorimi i sistemit të komunikimit përmes kontakteve dhe takimeve të përbashkëta me klientët dhe shfrytëzuesit e shërbimeve tona;
- ✓ Monitorimi i lëvizjes së trenave të udhëtarëve dhe mallrave në orar të paraparë sipas OLT-së.
- ✓ Monitorimi i realizimit të projekteve kapitale sipas kohës dhe buxhetit të paraparë.
- ✓ Monitorimi i inkasimit të mjeteve financiare

XII. Detyrimet karshi konsumatorëve dhe publikut

Gjatë vitit 2012 ne do të fokusohemi që të vazhdojmë plotësimin e detyrimeve tona karshi konsumatorëve tanë si dhe publikut të gjerë. Duke marrë parasysh kategoritë e ndryshme të konsumatorëve tanë dhe meqenëse shërbimet tona i drejtohen më shumë se një tregu, ne i kemi ndërlidhur disa detyrime bazë që mendojmë të mbajmë drejt secilës kategori të konsumatorëve të cilat janë:

- Transparenca;
- Korrektësia; dhe
- Trajtimi jo diskriminues.

Sikur në ofrimin e shërbimeve të qasjes në rrjetin hekurudhor e po ashtu në dhënien me qira të pronës së hekurudhës, ne mendojmë që gjatë këtij viti të zhvillojmë edhe më shumë angazhimet tona drejt këtyre detyrimeve, në mënyrë që konsumatorët tanë të janë të kënaqur me shërbimet tona.

Ndërsa sa i përket detyrimeve tona karshi publikut të gjerë, ne gjatë vitit 2012 do të punojmë në mënyrë që veprimtarinë tonë ta zhvillojmë duke ndikuar në ngritjen e mirëqenies së qytetarëve të vendit tonë.

Në këtë drejtim gjatë këtij viti ne do të fokusohemi në:

- Ngritjen e sigurisë së qarkullimit të trenave;
- Ofrimin e të gjitha shërbimeve shtesë sipas standardeve më të larta; dhe
- Ofrimin e shërbimeve tona sa më transparente dhe konkurruese në mënyrë që infrastruktura e jonë të jetë atraktive edhe për operatorët tjerë të transportit.

Ne jemi zotuar për një angazhim maksimal të të gjithëve dhe mbikëqyrje të pandërprerë në realizimin e detyrave të parapara në mënyrë që plani i biznesit për vitin 2012 të realizohet me sukses.